



Prishtinë: 24.09.2018  
Kodi i ZRRE-së: V\_1045\_2018

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1841\_08\_18**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **05.09.2018**.

### në seancën e mbajtur më datë 24.09.2018, nxori këtë:

#### V E N D I M

- I **REFUZOHE**t ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin I. G. nga Ferizaji, me shifër të konsumatorit: DFE - 9017480, si e pa bazuar.
- II **MBETET** në fuqi vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_1841\_08\_18 i datës 07.08.2018.

#### A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 05.09.2018 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: Përfaqësuesi i KESCO-së, në ankesë ka theksuar se fatura e muajit 04/2016 është në rregull dhe e bazuar në procesverbalin e qendrës së kalibrimit. Në ankesë është theksuar se analiza e DMK se konsumatori ka ndryshim në shpenzimin e energjisë elektrike nuk mund të merret e saktë, ngase shpenzimi i energjisë në periudha të ndryshme ndryshon, pra prej periudhës 06/2015 deri më 10/2015 është 1707 kWh/muaj,, ndërsa prej periudhës 12/2015 deri më 04/2016 është 1728 kWh/muaj. Në ankesë është theksuar se pretendimi i organi të shkallës së parë se fatura 04/2016 nuk paraqet shpenzim real mujor nuk është i saktë pasi që sipas procesverbalit të kalibrimit njehsori është brenda kufijve të lejuar. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK\_V\_1841\_08\_18 i datës 07.08.2018 për konsumatorin Islam Gurgurovci me shifër DFE - 9017480.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 24.09.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.



Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se fatura e muajit 04/2016 është në rregull dhe e bazuar në procesverbalin e qendrës së kalibrimit, Bordi i ZRRE-së thekson se gjatë shqyrtimit të lëndëve të konsumatorit nuk mund të merret për bazë vetëm procesverbali i kalibrimit dhe të theksohet se ajo është provë meritore dhe asnjë dëshmi tjetër, pa u shqyrtuar edhe dëshmitë tjera. Bordi i ZRRE-së thekson se DMK shpenzimi i faturuar i KESCVO për konsumatorin për periudhën 04/2016 ka qenë 6272 kWh, ndërsa në asnjë muaj tjerë nuk kemi shpenzim të ngjashëm të konsumatorit, andaj bazuar në analizat e bëra konstaton se konsumatori në periudha kontestuese 03/2013 nuk është faturuar me shpenzimet reale për shkak të mos matjes së saktë të njehsorit elektrik.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se analiza e DMK rreth krahasimit të shpenzimeve nuk mund të merren si të sakta, pasi me njehsor të ndryshëm ka shpenzim të ndryshëm, Bordi i ZRRE-së thekson se kjo nuk qëndron, pasi që bazuar në analizën e përgjithshme të energjisë elektrike konstatohet se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve të energjisë elektrike, por që gjatë krahasimit të shpenzimeve për periudhën kontestuese me periudhat e njëjta të më hershme dhe të mëvonshme me dy njehsorët elektrik, njehsorin elektrik kontestues nr.200417, si dhe njehsorin e ri elektrik nr.30515134, konsumatori ka ndryshim në shpenzimin e energjisë elektrike vetëm në periudhën 04/2016 me njehsorin kontestues. Sipas rrjedhës se energjisë elektrike shpenzimi i konsumatorit për periudhat e më hershme me njehsorin elektrik kontestues nr.200417: periudha 04/2012 është 227 kWh, periudha 04/2013 është 247 kWh, periudha 04/2014 është 680 kWh, periudha 04/2015 është 770 kWh, 04/2016 është 6,272 kWh, kurse me njehsorin e ri elektrik nr.30515134: periudha 04/2017 është 623 kWh dhe 04/2018 është 888 kWh. Po ashtu duhe theksuar se Bordi i ZRRE-së ka analizuar shpenzimin e energjisë elektrik për periudha të njëjta me të gjata me dy njehsorët dhe vëren se: me njehsorin elektrik kontestues nr.200417 periudha 06/2014 deri në periudhën 12/2014 mesatarja e shpenzimit është 1453 kWh/muaj, si dhe periudha 06/2015 deri në periudhën 12/2015 mesatarja e shpenzimit është 1375 kWh/muaj kurse me njehsorin e ri elektrik nr.30515134 periudha 06/2016 deri në periudhën 12/2016 mesatarja e shpenzimit është **1328 kWh** dhe periudhën 06/2017 deri në periudhën 12/2017 mesatarja e shpenzimit është **1070 kWh**. Pra Bordi i ZRRE-së thekson se bazuar në analizat e bëra konstatohet se konsumatori në periudhën kontestuese 04/2016 nuk është faturuar me shpenzimet reale për shkak të mos matjes së saktë të njehsorit elektrik. Vlen të theksohet se sipas analizave të bëra shpenzimit të energjisë elektrike të konsumatorit, është vërejtur se njehsori elektrik nr.200417 ka regjistruar energjinë elektrike saktë prej fillimit e deri në periudhën 06/2014, ku gjendja e tarifës së lartë ka tentuar të barazuar me gjendjen e tarifës së ulët.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se pretendimi i organit të shkallës së parë se fatura 04/2016 nuk paraqet shpenzim real mujor nuk është i saktë, Bordi i ZRRE-së thekson se bazuar në transaksionet e konsumatorit vërtetohet se departamenti i faturimit në KESCO me datë 28.09.2016 përmes urdhër lejimit/korrigjimit nr.43623DFE-9017480 ka bërë korrigjimin në vlerë -32.14 € duke bërë shpërndarjen e kWh të faturuar në periudhën 04/2016 për periudhën 12/2015 deri në periudhën 04/2016. DMK ka shqyrtuar korrigjimin dhe konstaton se edhe përkundër shpërndarjes së kWh të faturuar në periudhën 04/2016 për periudhën 12/2015 - 04/2016 kjo nuk paraqet shpenzim real të konsumatorit krahasuar edhe me shpenzimet e më hershme, si dhe të më vonshme për periudhën e njëjtë. DMK duke pasur parasysh këto të gjetura konstaton se konsumatorit duhet t'i anulohet korrigjimi nr.43623DFE-9017480 të datës 28.09.2016, si dhe faturat nr.0416316DFE-9017480 dhe nr.0416416DFE-9017480 të datës 11.04.2016, e që për periudhën 04/2016 konsumatori të faturohet me shpenzimet e regjistruara në periudhën 04/2017 me njehsorin elektrik nr. 30515134 ku TL=521 kWh dhe TU=102 kWh.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk



është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 24.09.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Arsim Janova, u.d. kryesues

\_\_\_\_\_  
Besim Sejfiqaj, anëtar

\_\_\_\_\_  
Selman Hoti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit I. G. dhe
- Arkivit të ZRRE-së